

VENDIM
Nr. 435, datë 17.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 504, DATË 6.7.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3, e kreut II, të vendimit nr. 504, datë 6.7.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. AKUK-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për infrastrukturën. Drejtori i Përgjithshëm në veprimtarinë e tij mbështetet nga 2 (dy) zëvendësdrejtore të përgjithshëm.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi